

VENDIM
Nr. 666, datë 10.10.2019

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE DHE
PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR PËRFITIMIN E BURSIVE E TË PAGESAVE
PËR NXËNËSIT E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR NË INSTITUCIONET
ARSIMORE PUBLIKE**

(Ndryshuar me VKM nr. 752, datë 30.11.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 19, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të pikës 2, të nenit 32, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 5, të ligjit nr. 10289, datë 17.6.2010, “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 2, të ligjit nr. 7889, datë 14.12.1994, “Për statusin e invalidëve të punës”, të ndryshuar, të nenit 6, të ligjit nr. 8153, datë 31.10.1996, “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar, të nenit 8, të ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar, të nenit 12, të ligjit nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Nxënësit, të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, mund të përfitojnë bursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim nga buxheti vjetor i miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:

2.1 Kriteri ekonomik:

a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;

b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe që akomodohen në konvikte publike;

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:

Nxënësit e arsimit profesional, të cilët kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me notën mesatare 9 (nëntë) deri në 10 (dhjetë).

2.3 Kriteri joekonomik:

a) nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin e jetimit;

b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;

c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;

- c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
- d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;
- dh) nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimë të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
- ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- f) nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;
- g) nxënësit me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimor si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse listën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.

2.4 Kriteri i degëve parësore të zhvillimit ekonomik të vendit dhe vendbanimit të përhershëm:

a) nxënësit, të cilët ndjekin me kohë të plotë arsimin profesional në drejtimet mësimore bujqësi, veterinar, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit;

b) nxënësit me vendbanim të përhershëm në Dibër, Bulqizë, Mat, Kukës, Has, Tropojë, Pukë, Mirditë, Malësi e Madhe, Librazhd, Gramsh, Kolonjë, Përmet, Skrapar dhe Tepelenë.

3. Nxënësit e të gjitha kategorive të mësipërme nuk përfitojnë bursë ose humbasin të drejtën e përfitimit të saj kur:

- a) janë ndarë nga trangu familjar;
- b) familjet e tyre ushtrojnë veprimtari private;
- c) deklarohen mbetës apo përsëritës dhe humbasin vitin shkollor për arsye të rezultateve jokalue.

4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, miratojnë bursa financiare me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, pas konfirmimit nga mësuesi kujdestar dhe drejtori i shkollës për frekuentimin e procesit mësimor, si dhe nga zyra vendore e arsimit parauniversitar.

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për kategorinë e nxënësve që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimin bazë, dhe për uljen e braktisjes shkollore të arsimit bazë, mund të miratojnë dhe të shpërndajnë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

6. Ministria përgjegjëse për arsimin, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilin e dërgon në njësitë e vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se muaji tetor.

7. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me ofruesit publikë të arsimit profesional, harton planin e shpërndarjes së bursave për hyrjet e reja (në vitin e parë), të cilin e dërgon në njësitë e vetëqeverisjes vendore, jo më vonë se muaji tetor.

8. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6, të këtij vendimi, me vendim të këshillit bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi.

9. Bursat e nxënësve për vitin e parë (klasën e 10) shqyrtohen dhe miratohen nga këshilli bashkiak, sipas vendbanimit të përhershëm të prindit/nxënësit, përfitues të kuotës financiare/kuotës ushqimore (bursës).

10. Nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë vitin e parë (klasën e 10) me vendim të këshillit bashkiak ku ata kanë vendbanimin e përhershëm, të cilëve nuk u ndryshojnë kriteret ekonomike dhe nuk rezultojnë mbetës, e përfitojnë bursën deri në përfundim të viteve të shkollimit.

11. Nxënësit e shkollave profesionale, të cilët ndjekin vitin e dytë në drejtimet mësimore bujqësi, veterinari, pyje, ndërtim, peshkim, detari, gjeologji-miniera dhe shpim e shfrytëzim i vendburimeve të naftës dhe gazit, dhe nxënëset (vajza), sipas shkronjës “F”, të pikës 2.3, të cilët kanë përfituar bursë në vitin e parë dhe në vitin shkollor paraardhës nuk rezultojnë mbetës, përfitojnë bursë deri në përfundim të viteve të shkollimit.

12. Të gjithë nxënësit/prindërit dhe drejtoritë e shkollave profesionale, për nxënësit që regjistrohen për herë në klasën e 10, të cilët përfitojnë bursë sipas kriterëve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4, të këtij vendimi, i dërgojnë zyrtarisht kërkesat për miratimin e bursës në njësitë e vetëqeverisjes vendore të vendbanimit të përhershëm të nxënësit.

13. Nxënësit, të cilët gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore kanë përfituar bursë nga njësia e vetëqeverisjes vendore, e përfitojnë atë edhe gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës profesionale. Bursa jepet në formën e kuotës ushqimore ose të kuotës financiare, në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve, të çelur pranë bankave të nivelit të dytë.

14. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet t’u dërgojnë zyrtarisht, jo më vonë se muaji dhjetor i çdo viti, drejtorive të shkollave të arsimit profesional dhe zyrave vendore të arsimit parauniversitar vendimet për dhënien e bursave, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës.

15. Njësitë e vetëqeverisjes vendore duhet të raportojnë zyrtarisht, çdo tre muaj, pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin për fondet buxhetore të shpenzuara dhe numrin e nxënësve të arsimit parauniversitar dhe të arsimit profesional, që trajtohen me kuota ushqimore në konvikte dhe bursa.

16. Për nxënësit, të cilët kanë përfituar bursë, drejtorët e shkollave të arsimit profesional si dhe të shkollave të tjera të arsimit parauniversitar dërgojnë zyrtarisht, në datën 5 të çdo muaji, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, informacion për frekuentimin e shkollës/praktikës profesionale nga nxënësit që përfitojnë bursë.

17. Nxënësit, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë, përfitojnë çdo vit, falas, veshmbathje, libra dhe fletore, sipas pasqyrës nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Nxënësit e Institutit të Fëmijëve që nuk Dëgjojnë dhe të Institutit të Fëmijëve që nuk Shikojnë përjashtohen nga detyrimet e tarifave të shërbimeve të ndryshme, që ofrojnë institucionet shtetërore.

18. Nxënësve, të cilët kanë përfituar statusin ligjor të jetimit, invalidit paraplegjik, tetraplegjik, statusin ligjor të personave që nuk shikojnë, të personave që nuk dëgjojnë, u sigurohen falas akomodimi/fjetja, shërbimi shëndetësor, shërbimi dentar dhe medikamentet pas paraqitjes së librezës, kartës shëndetësore dhe epikrizës, nga qendra spitalore e rrethit.

19. Nxënësit jetimë, të cilët ndjekin procesin mësimor në institucionet publike të arsimit parauniversitar, trajtohen me pagesë suplementare edhe për periudhën e pushimeve verore nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale.

20. Nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët ndjekin shkollat e mesme profesionale, përfitojnë falas veshmbathje, libra dhe fletore, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

21. Nxënësit dhe mësuesit e institucioneve të arsimit special, me nevoja të veçanta psiko-sociale, pa konvikt, trajtohen me fonde të buxhetit të shtetit, me një kuotë ushqimore (drekë) me vlerë deri në 150 (njëqind e pesëdhjetë) lekë në ditë, sipas kuotës financiare të përcaktuar në pasqyrën nr. 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

22. Nxënësve të arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5km dhe që akomodohen në konvikte publike, bursa u jepet në formën e kuotës ushqimore. Në asnjë rast, bursa nuk jepet në formën e kuotës financiare.

23. Fondet buxhetore për mbulimin e shpenzimeve për bursat si dhe numri i bursave për nxënësit administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas vendndodhjes territoriale dhe

administrative të konvikteve ku janë vendosur nxënësit konviktorë. Masa mujore e bursës u jepet nxënësve në formën e kuotës ushqimore, në konvikt.

24. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë sipas rezultateve të arritura, jashtë kriterit ekonomik, të akomoduar në konvikte ose jo, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve.

25. Nxënësve, të cilët përfitojnë bursë në arsimin profesional, sipas shkronjave “dh” e “f”, të pikës 2.3, dhe shkronjës “a”, të pikës 2.4, masa e miratuar e bursës mujore u paguhet nga njësia e vetëqeverisjes vendore çdo muaj, pranë bankave të nivelit të dytë, në llogarinë bankare në emër të prindit/prindërve ose të përfaqësuesit ligjor, për llogari të nxënësve.

26. Njësitë e vetëqeverisjes vendore realizojnë pagesën e bursës mujore për nxënësit përfitues vetëm pasi drejtorët e shkollave profesionale konfirmojnë zyrtarisht, brenda datës 5 të çdo muaji, pranë njësive të vetëqeverisjes vendore, informacionin për ndjekjen e shkollës/mësimin për nxënësit që përfitojnë bursë.

27. Nxënësve, të cilët nuk ndjekin mësimin/shkollën apo praktikën profesionale pa shkaqe të ligjshme, u ndërpritet bursa menjëherë.

28. Masa e bursës dhe kuota financiare ushqimore ditore për nxënësit jepet, respektivisht, sipas pasqyrave nr. 2 dhe nr. 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

29. Ministria përgjegjëse për arsimin profesional, për pranimet e reja në vitin e parë në sistemin arsimor publik, që ndjekin shkollat profesionale, të japë 2 400 (dy mijë e katërqind) bursa.

30. Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, të japë 1 200 (një mijë e dyqind) bursa.

31. Efektet financiare të këtij vendimi përballohen nga fondet e buxhetit të shtetit, miratuar për ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

31.1 Përjashtimisht për vitin shkollor 2019-2020 përfitojnë bursë në masën 15 000 (pesëmbëdhjetë mijë) lekë në muaj nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, fëmijë të personave që kanë humbur jetën ose janë shpallur të zhdukur në qarqet Durrës, Tiranë dhe Lezhë, si pasojë e tërmetit të datës 26.11.2019. Institucionet arsimore vendore përkatëse, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, në bashkëpunim me njësitë përkatëse të vetëqeverisjes vendore, identifikojnë nxënësit dhe dërgojnë listat e nxënësve të identifikuar për miratim në ministrinë përgjegjëse për arsimin dhe ministrinë përgjegjëse për arsimin profesional.

32. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, për të gjitha kategoritë e shkollave, është muaji dhjetor.

33. Vendimet e këshillave të njësive të vetëqeverisjes vendore, në raste të veçanta, mund të miratohen përtej këtij afati vetëm me urdhër të ministrit përgjegjës për arsimin parauniversitar apo për arsimin profesional, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore përkatëse.

34. Vendimet e njësive të vetëqeverisjes vendore bëhen publike në faqen zyrtare të institucionit për nxënësit/prindërit/përfaqësuesit ligjorë, komunitetin, median dhe institucionet e tjera qendrore apo vendore, publike ose private.

35. Ngarkohen Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

**PASQYRA NR. 1
KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS**

Nr.	Përbërja familjare	Përfitojnë bursa	Përfitojnë gjysmë bursa	Me pagesë
-----	--------------------	------------------	-------------------------	-----------



	<i>Për qytetin</i>	<i>Me të ardhura mujore lekë/ frymë</i>	<i>Me të ardhura mujore lekë/ frymë</i>	<i>Me të ardhura mujore lekë/ frymë</i>
1	Për familjet me 2 persona	deri 3,200	3,200 - 4,600	mbi 4,600
2	Për familjet me 3 persona	deri 3,100	3,100 - 4,500	mbi 4,500
3	Për familjet me 4 persona	deri 3,000	3,000 - 4,400	mbi 4,400
4	Për familjet me 5 persona	deri 2,900	2,900 - 4,300	mbi 4,300
5	Për familjet me 6 persona	deri 2,800	2,800 - 4,200	mbi 4,200
6	Për familjet me 7 persona	deri 2,700	2,700 - 4,100	mbi 4,100
7	Për familjet me 8 persona	deri 2,600	2,600 - 4,000	mbi 4,000

PASQYRA NR. 2
MASA E BURSËS PËR NXËNËSIT (NË LEKË)

Nr.	Kategoritë e bursave sipas shkollave	Kuotat e bursës mujore në lekë			Financimi	
		<i>Lekë për kuotë ushqimi</i>	<i>Shpenzime vetjake (higjienë personale, mjete mësimore)</i>	<i>Totali i kuotës</i>	<i>Financimi nga nxënësi/ prindër</i>	<i>Financimi nga shteti</i>
1	Shkollat 9-vjeçare dhe të mesme					
	a) Bursa	6,455	600	7,055	0	7,055
	b) Gjysmë bursa	6,455	600	7,055	3,527.5	3,527.5
	c) Me pagesë	6,455	600	7,055	7,055	0
2	Shkolla e Mjeshtërisë Sportive e Arsimit Special					
	a) Bursa	7,017	600	7,617	0	7,617
	b) Gjysmë bursa	7,017	600	7,617	3,808.5	3,808.5
	c) Me pagesë	7,017	600	7,617	7,617	
3	Për nxënësit jetimë	7,017	600	7,617	0	7,617

PASQYRA NR. 3
KUOTAT FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIMIN E NXËNËSVE

Nr.	Emërtimi	Njësia matëse	Norma ditore	Vlera energjetike (në kcal)	Çmimi mesatar në lekë	Vlera ditore në lekë
1	Bukë	gramë	350-400	977	100	35
2	Makarona	gramë	30	107	120	3.6
3	Oriz	gramë	30	109	150	4.5
4	Sheqer	gramë	40	157	100	4
5	Fasule	gramë	30	93	200	6
6	Perime	gramë	130	27	100	13
7	Fruta	gramë	100	42	100	10
8	Vaj	gramë	30	270	180	5.4
9	Gjalpë	gramë	20	152	650	13
10	Mish	gramë	70-80	115	750	52.5
11	Djathë	gramë	25	40	600	15
12	Reçel	gramë	20	93	250	5
13	Vezë	kokërr	1	42	12.5	12.5
14	Qumësht	gramë	200	98	80	16
15	Patate	gramë	200	170	40	8
16	Nënprodukte mishi	gramë	30	100	400	12
	Kuota ditore			2712		215.5

Shënim. Është e domosdoshme që nxënësi të marrë kuotën ditore në lekë dhe në kalori, ndërsa gramaturat dhe lloji i ushqimit mund të ndryshojnë sipas menyve të ndryshme, sipas



çmimeve që ofrohen nga konkurrenca e në procesin e prokurimeve publike dhe ndikimit të faktorëve të tjerë (gramaturat e normës ditore në pasqyrë janë përdorur për efekt planifikimi).

PASQYRA NR. 4
KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES

Nr.	Emërtimi	Kuota financiare në lekë e veshmbathjes për një vit kalendarik
1	Për fëmijët e arsimit special	7,000 (shtatë mijë) lekë
2	Për nxënësit që ndikojnë në nivelin e braktisjes shkollore që janë “rikthyer” në institucionet arsimore.	10,000 (dhjetë mijë) lekë
3	Për nxënësit romë dhe egjiptianë	10,000 (dhjetë mijë) lekë
	Për nxënësit jetimët	10,000 (dhjetë mijë) lekë